



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**  
**Komuna e Gjilanit**  
**Opština Gnjilane**  
**Municipality of Gjilan**  
**Gilan Belediyesi**



---

**R R E G U L L O R E**

**P Ë R**

**NDARJEN E SUBVENCIONEVE**

**Gjilan, 2012**

Në pajtim me nenin 12 pika c, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen e Lokale (Gaz. e R.K nr. 28 datës 4 qershor 2008), neni 43 paragrafi 3 Rregulla Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit 02-Shpenzimi i Parave Publike, Udhëzimit Administrativ nr. 2005/08 MEF-it - Klasifikimi ekonomik i shpenzimeve dhe neni 39 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 16-53125 të datës 11.11.2011, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me dt. 09.02.2012, miratoi:

## **R R E G U L L O R E N P Ë R N D A R J E N E S U B V E N C I O N E V E**

### **I. DISPOZITAT E PËRGJTHSHME**

#### **Qëllimi**

##### **Neni 1**

1. Me këtë rregullore përcaktohen kriteret dhe procedura e ndarjes së mjeteve të buxhetit të komunës – fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale, personave fizik dhe juridik.
2. Bazuar në fondin e ndarë buxhetor të subvencioneve dhe transfereve për vitin aktual, Kryetari i Komunës sipas kërkesave të arsyetuara të palëve, ndan mjete financiare buxhetore – ndihmë momentale, për personat juridik dhe fizikë sipas procedurës së përcaktuar me këtë rregullore.

##### **Neni 2**

Ndihmë momentale sipas kësaj rregulloreje konsiderohet ndihma e menjëhershme në para të gatshme që propozohet nga komisioni përkatës i formuar me Vendim të Kryetarit të Komunës dhe të miratuar nga ai.

##### **Neni 3**

Ndihma momentale për personat juridik (institucionet jofitimprurëse) dhe personat fizik përfshinë mbështetjen që u jepet institucioneve kulturore amatore, sportive amatore, organizatave jo qeveritare dhe personave fizik me nevojë.

#### **Ndihmë momentale për personat juridik (institucionet jofitimprurëse)**

##### **Neni 4**

1. Kërkesat e personave juridik për subvencione duhet t'i drejtohen Kryetarit të Komunës përmes zyrës së pranimit. Kërkesa duhet të jetë e kompletuar me dokumentacionin mbështetës si:
  - 1.1. certifikatën e regjistrimit,

- 1.2. arsyetimi i kërkesës me provë të qartë dhe bindëse si dhe
- 1.3. numri i llogarisë bankare të personit juridik jofitimprurës.
- 1.4. informatë vjetore mbi [aktivitetin](#) dhe qarkullimin financiar.

## Neni 5

Kryetari i komunës pas pranimit të kërkesës, e autorizon drejtorinë përkatëse, të jep mendim profesional për përfituesit në afat prej 15 ditësh. Pas shqyrtimit të kërkesës, drejtoria përkatëse i propozon Kryetarit të Komunës për aprovim kërkesën e justifikuar dhe të dëshmuar me dokumentacionin përcjellës.

## Neni 6

1. Kryetari i Komunës, merr vendim lidhur me kërkesën e personit juridik, deri në shumën e përcaktuar me këtë rregullore.
2. Kryetari i Komunës sipas paragrafit 1 të këtij neni, lejon ndarjen e subvencioneve për persona juridik deri në shumën prej 2000€.
3. Nëse ndihmat financiare kanë të bëjnë me shumë më të madhe, se që është përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni dhe në paragrafin 1 të nenit 9 të kësaj rregulloreje, për të njëjtën vendosë Komiteti për Politikë dhe Financa me vendim paraprak mbi delegimin e kësaj kompetence, kurse Kuvendit i paraqitet raport për çdo gjashtë (6) muaj.
4. Nga shuma e mjeteve financiare të parapara me buxhet për KK-në, mund të ndahet një shumë e caktuar si subvencion nga kryesuesi i KK-së për nevoja të ndonjë aktiviteti që lidhet me punën e Kuvendit të Komunës e që shuma nuk mund të jetë më e madhe se 1000€.
5. Paraprakisht për lejimin e shpenzimeve sipas paragrafit 4 të këtij neni i bëhet kërkesë Kryetarit të Komunës për lejimin e shpenzimeve.

**Kriteret për financimin e projekteve nga subvencionimi.**

## Neni 7

1. **Projektet nga fusha e kulturës** (Promovimet e vlerave përmes të festivaleve, koncerteve, shënimin e datave historike dhe kulturore, simpoziumet, ekspozitave dhe promovimi i librave të botuara etj...). Shumat e mjeteve caktohen sipas strukturës komplekse të projektit (promovimet);
  - 1.1. Veprimtaria botuese (bëhet kryesisht për shpenzimet e shtypit, ndërsa donacioni fitohet në bazë të recensionit nga dy krijues të verifikuar në lëmin përkatëse letrare);
  - 1.2. Veprimtaria teatrale (vlerësimi bëhet në bazë të kalkulimit të shpenzimeve të

- shfaqjeve teatrale);
- 1.3. Veprimtaria filmike (vlerësohet sipas pozicioneve buxhetore të shpenzimeve të kalkuluar sipas zhanrit dhe skenarit në vlerë prej 30 deri në 40%, pasi pozicionet filmike janë më të shtrenjta se ato teatrale);
  - 1.4. Artet pamore (subvencionohet botimi i katalogëve dhe kornizimi i pikturave);
  - 1.5. Trashëgimia kulturore (hulumtimi i trashëgimisë, gërmimet arkeologjike, ruajtja, restaurimi dhe konservimi i vlerave të trashëgimisë mbështetet sipas rëndësisë së objekteve që duhet hulumtuar dhe ruajtur dhe atë në faza. Vlerësimi për ndarjen e shumave bëhet sipas mendimit të ekspertëve të fushës së caktuar në lartësi deri në 40% pasi gërmimet, restaurimet dhe konservimet janë të kushtueshme.
  - 1.6. Grupet Artistike të Gjilanit (puna e tyre vlerësohet duke u mbështetur në realizimin e suksesshëm të programeve të mirëfillta që kanë vlera artistike. Projektet e tyre që duhet mbështetur janë: pjesëmarrja në festival në vend, mundësisht edhe jashtë vendit, koncertet e ndryshme në qytet dhe në Kosovë, pajisjet me gardërobë konvencionale dhe instrumente muzikore, ndihmat logjistike-sigurimi i sallave për mbajtjen e koncerteve, lokalet ku do t'i përgatitin programet, automjetet për udhëtime të shkurtra dhe ndonjë ndihmë tjetër ku Komuna nuk ka shpenzime të theksuara).
  - 1.7. Projektet duhet të ketë vlera krijuese artistike.

## 2. Projektet për çështje gjinore dhe integritet socio – kulturore që promovojnë:

- 2.1. arrijtjen e barazisë gjinore nëpërmjet integritetit të perspektivës gjinore në të gjitha sferat,
- 2.2. përmirësimin e mbrojtjes dhe parandalimit të dhunës në familje,
- 2.3. eliminimin e pabarazisë së grave dhe vajzave në veprimtarit shoqërore dhe politike, në varfëri, në forcat e punës, në arsim dhe shëndetësi etj.,
- 2.4. integritetin e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat;
- 2.5. përkrahjen në aftësimin e përkthyesve të shenjave për personat me pengesa në të dëgjuar si kategori e veçantë si dhe projektet tjera me interes për këtë çështje.

## 3. Projektet në fushën e rinisë (Mbulimi i shpenzimeve të qirasë së Qendrës Kulturore të të rinjve të Gjilanit në rast nevojë dhe për projekte tjera për fuqizimin e rinisë, organeve të saja (KVRL) etj.

## 5. Projektet në fushën e sportit;

- 5.1. Masivizimi i sportit për të rinj;
- 5.2. Bashkëpunim me drejtoritë të cilat merren me punën e të rinjve dhe të rejave për masivizimin e sportit dhe ngritjes kualitative të sportistëve;
- 5.3. Përkrahje të qëndrueshme financiare për sportistët kulmor dhe klubet kualitative, të cilat mund të arrijnë rezultate të mira sportive;
- 5.4. Avancimin e organizimit në klubet sportive të femrave të cilat veprojnë në rrafshin sportiv kosovar (masivizimi i sportit ndër femra);

- 5.5. Bashkëpunimi me Organizata të ndryshme sportive vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të realizimit të projekteve të ndryshme sportive që kanë të bëjnë me ngritjen dhe avancimin e trajnerëve të cilët punojnë me grupmosha të ndryshme;
- 5.6. Integrimin e minoriteteve në aktivitete dhe në gara të rregullta kosovare;
- 5.7. Kultivimin dhe avancimin i kualiteteve menaxhuese, në mënyrë që me anë të animimit të donatorëve të gjenden mjete plotësuese financiare për funksionimin profesional dhe amator të Klubeve sportive;
- 5.8. Përkrahje të vazhdueshme për Shoqatat e Pedagogëve të Kulturës Fizike me qëllim të zhvillimit të Ligës shkollore në nivel lokal dhe rajonal;
- 5.9. Partneritet me të gjitha organizatat sportive për implementimin e politikave zhvillimore afat shkurtë dhe afat gjatë;
- 5.10. Punë e vazhdueshme edukative me tifozët që janë pjesë përbërëse e Sportit, me qëllim të evitimit të dhunës dhe me qëllim të kultivimit të vlerave fisnike të sportit;
- 5.11. Përkrahja e organizimit të klubeve dhe organizimeve për persona me aftësi të kufizuara.

#### 6. Kriteret për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të OJQ-ve:

- 6.1. Promovimi i vullnetarizmit (aktivitetet për shërbime të arsimit, avokim, kampanjë, menaxhment, aktivitete komunitare dhe ambiente etj...);
- 6.2. Integrimi i grupeve të marginalizuara;
- 6.3. Fuqizimi i organizatave rinore (seminare, trajnime, kurse për aftësimin e të rinjve);
- 6.4. Edukimi joformal (stimulimi i të miturve për edukim dhe arsimim);
- 6.5. Punësimi i të rinjve dhe
- 6.6. Infrastruktura për rini, për moshën e mesme, pleq dhe pensionist.

#### 7. Kërkesa duhet të këtë provat si në vijim:

- 7.1. Projekt- propozimi (në projekt propozim duhet të përshkruhet aktiviteti me agjendën e planifikuar si dhe specifikimi i projektit);
- 7.2. Certifikata e OJQ-së ;
- 7.3. Fotokopja e kartelës së xhirollogarisë dhe letërnjoftimin e bartësit të kartelës;
- 7.4. Shënimet e personit kontaktues.

### **Subvencionet për individë dhe familje**

#### **Neni 8**

Kryetari i Komunës, sipas kërkesave të arsyetuara ndanë ndihmë momentale nga fondi për transfere dhe subvencione të Komunës, për raste urgjente të shkaktuara nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore, varfëri të skajshme për familje apo individ të caktuar me sëmundje të rënda që kërkojnë mjekim të kushtueshëm dhe për raste tjera të arsyeshme.

### **Neni 9**

1. Kryetari i Komunës, lejon ndarjen e subvencioneve për persona dhe familjet në nevojë si ndihmë materiale për përkujdesje sociale dhe shëndetësore, shumë e cila mund të jetë deri në 1200€.
2. Ndihma materiale e cekur ne paragrafin 1 të këtij neni, nënkupton sigurimin e të hollave, ushqimit apo kompensimin e trajtimit të domosdoshëm mjekësor për një individ apo familje.
3. Për çdo shumë më të lartë nga ajo e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, vendos Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

### **Neni 10**

1. Kriteret që duhet të plotësohen për të qenë përfitues i ndihmës materiale;
  - 1.1. Sëmundja e rëndë e konstatuar me dokumentacionin mjekësor të specialistit;
  - 1.2. Gjendja e rëndë ekonomike – familjare e vërtetuar;
  - 1.3. Dëshmia e shpenzimeve mjekësore dhe shpenzimeve të tjera dhe
  - 1.4. Dëshmia për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë e mundshme elementare.

### **Neni 11**

Kërkesë për ndihmë momentale mund të paraqesin vetëm personat dhe familjet që janë banorë të përhershëm të Komunës së Gjilanit.

### **Organi kompetent për shqyrtimin e kërkesave**

### **Neni 12**

1. Komisioni i formuar nga Kryetari i Komunës në përbërje të zyrtarëve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, është kompetent për shqyrtim të kërkesës eventuale për ndihmë momentale individit apo familjes dhe në afat prej 15 ditësh të bënë propozimin e mundshëm për ndihmë momentale. Kërkesat e pakompletuara, komisioni nuk do t'i procedoj më tutje.
2. Kërkesat që nuk i plotësojnë kriteret për ndihmën momentale do të refuzohen nga Kryetari i Komunës me propozim të Komisionit.

### **Neni 13**

Shuma e ndihmës momentale për personat fizikë dhe familjar propozohet nga Komisioni deri në limitin e përcaktuar në nenin 9 paragrafi 1 të kësaj rregulloreje. Personi dhe familja e

caktuar mund të ndihmohet vetëm një herë në vit me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme.

#### **Neni 14**

Komisioni, listën e specifikuar të propozuar për ndihmë momentale ja dorëzon Kryetarit të Komunës, i cili ka mundësi ta ndryshojë para se të propozohet për miratim, duke potencuar arsyetimin për ndryshime.

## **II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 15**

Për zbatimin e kësaj rregullore do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa e komunës së Gjilanit.

#### **Neni 16**

Në raste konflikti të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe dispozitave të rregullave financiare dhe Udhëzimit Thesarit 02-shpenzimi parave publike dhe Udhëzimi Administrativ nr. 2005/08 MEF-it, klasifikimi ekonomik i shpenzimeve, do të aplikohen dispozitat e këtyre të fundit

### **Hyrja ne fuqi**

#### **Neni 17**

Kjo rregullore hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

## **KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT**

**01. nr.16/16477**

**Gjilan, më 09.02.2012**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

---

**/Izmi Zeka/**